



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:030410

Datë: 06.05.2019

Numri i dokumentit: 00301148

**P. nr. 764/18**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. H nga fsh. . . .K Deçan, për shkak të veprës penale të ngacmimit nga neni 186/1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.nr.761/18 të datës 25.10.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **11.04.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, të dëmtuarit K. A. ,mbrojtësit të akuzuarit av. B. H.si dhe të akuzuarit F. H ,të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. H nga fsh.. .K Deçan**, i biri i F. dhe i nënës H. e gjinisë M. , data e lindjes . . . ne Deçan , ka të kryer shkollën e mesme, vozitës , i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar ,atë i 3 fëmijëve , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, me ID . . .

### Ë s h t ë f a j t o r :

#### Sepse:

- **me datë 22.05.2018** ,rreth orës **09.00 min**, në fsh.O.H. K Gjakovë , e ngacmon të dëmtuarin K. O. A.nga fsh. O. H. K Gjakovë ,në atë mënyrë që pasi të njëjtën ditë H. A., vëllai i të dëmtuarit ,kishte pasur një përleshje fizike e gjatë kësaj përleshje të akuzuarit i kishte shkaktuar lëndime trupore , që ti hakmerret i akuzuari me automjetin e tij shkon të shtëpia e të dëmtuarit dhe e përcjell (vëzhgon ) e kur e vëren të dëmtuarin me automjet duke u kyçur nga rruga dytësore ne rrugën kryesore Gjakovë –Deçan , i akuzuari e ndal automjetin e me të shpejtë del nga automjeti i tij me një hu ne dorë , i vihet nga pas ,por i dëmtuari me automjetin lëviz nga pas e futet brenda në shtëpinë tij e arrin ti shmanget me të keqes.

**-me çka ka kryer veprën penale të ngacmimit nga neni 186/1 të KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,41,43,46,73 , nenit 186 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton;

### DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **500 (pesëqind ) euro**, ,të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **25 (njëzet e pesë ) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën e përcaktuar nga ana e gjykatës si dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumën prej **30.00 euro** ,ne afat prej **15 ditëve**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP.nr.761/18 të datës 25.10.2018, kundër të akuzuarit F. H nga fsh. . . .K Deçan ,për shkak te veprës penale të ngacimit nga neni 186 par.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 11.04.2019, Prokurori i shtetit Ismet Tofaj lexojë aktakuzën PP.nr. 761/18 të datës 25.10.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari F. H.,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë dhe pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. B. H.thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt për çka edhe i kërkojë falje për veprimet e mija dhe premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj i propozoj Gjykatës qe duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ,pendimi i shprehur ne gjykate për veprën e kryer ,kërkim falja e shprehur ne gjykate, premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla dhe do te jem me i kujdesshëm te me shqiptojë një dënim me te butë .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. B. H.deklaroi se e përkrahë deklaratën e te mbrojturit tim per pranimin e fajësisë me vullnete te plote dhe pa presion pas konsultimit te mjaftueshëm me mua. I propozoi gjykatës qe konform dispozitave ligjore te merr parasysh rrethanat lehtësuese te cilat i parasheh ligji e posaçërisht faktin se i njëjti me pare nuk ka ra ndesh me ligjin ashtu qe gjykata te i shqiptojë një dënim me te butë .

I dëmtuari K. A.deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari , nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qenë se jemi ne raporte miqësie dhe nga ajo ditë nuk kemi pasur ndonjë te keqe mes veti.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit Ismet Tofaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale nga te cilat formohet gjendja faktike si në dispozitiv te aktakuzës dhe gjithashtu formohen te gjitha elementet e veprës penale me te cilat ngarkohet i akuzuari .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari F. H : rreth orës **09.00 min**, në fsh.O. H. K Gjakovë , e ngacmon te dëmtuarin K. O. A.nga fsh. O. H. K Gjakovë ,në atë mënyrë qe pasi te njëjtën ditë H. A., vëllai i te dëmtuarit ,kishte pasur një përleshje fizike e gjatë kësaj përleshje te akuzuarit i kishte shkaktuar lëndime trupore , që ti hakmerret i akuzuari me automjetin e tij shkon te shtëpia e te

dëmtuarit dhe e përcjell (vëzhgon) e kur e vëren te dëmtuarin me automjet duke u kyçur nga rruga dytësore ne rrugën kryesore Gjakovë –Deçan, i akuzuari e ndal automjetin e me të shpejtë del nga automjeti i tij me një hu ne dorë, i vihet nga pas, por i dëmtuari me automjetin lëviz nga pas e futet brenda në shtëpinë tij e arrin ti shmanget me te keqes.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarit të shpalle fajtor dhe ta gjykohe ne bazë te ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e te akuzuarit, është baba i 3 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, premtimin se nuk do të përsërisë vepra penale, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga i dëmtuari, pendimin e shprehur për veprën e kryer, deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi, të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me gjobë ne shume prej 500 (pesëqind) euro, me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesën pasurore juridike ngase i dëmtuari K. A., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr. 764/18 më datë 11.04.2019**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15** ditësh nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.